

DETYRAT DHE FUNKSIONET E DREJTORIVE TË INSTITUCIONIT

Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka parashikuar edhe organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës (neni 18).

Institucioni në përbërje të tij ka dy struktura: (1) Komisionin e Konkurrencës dhe (2) Sekretariatit e Autoritetit të Konkurrencës.

Komisioni përbëhet nga Kryetari dhe 4 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi (neni 19).

Sekretariati drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, dhe në përbërje të tij janë nëpunësit e Sekretariatit, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil (neni 27, pika 1 dhe 2).

1. Komisioni i Konkurrencës

1.1. Komisioni i Konkurrencës përbëhet nga Kryetari dhe 4 anëtarë. Komisioni i Konkurrencës është organi vendimmarrës i Autoritetit dhe përbëhet nga pesë anëtarë. Ai vepron si një organ kolegjal i përhershëm. Anëtarët e Komisionit të Konkurrencës janë të zgjedhur nga Parlamenti i Shqipërisë. Mandati i tyre është 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje një herë. Komisioni ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- harton politikën kombëtare të konkurrencës;
- miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të Autoritetit;
- mbikëqyrë punën e Sekretariatit për zbatimin e dispozitave të ligjit;
- merr vendime sipas ligjit;
- nxjerr rregullore dhe udhëzime në zbatim të ligjit;
- brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës paraqet në Kuvend raportin vjetor të Autoritetit;
- me kërkesën e komisioneve të Kuvendit, jep vlerësime për çështje që lidhen me konkurrencën dhe legjislacionin në këtë fushë;
- u jep vlerësime dhe rekomandime organeve të administratës qendrore e vendore dhe institucioneve të tjera publike, shoqatave tregtare, sindikatave, shoqatave të konsumatorit, dhomave të tregtisë dhe të industrisë, për çështjet që lidhen me konkurrencën;

- përfaqëson Autoritetin brenda dhe jashtë vendit, në marrëdhëniet me institucionet e tjera dhe ato simotra;
- përcakton përparësitë e hetimeve dhe afatet përkatëse për hetimet.

2. Kabineti

2.1. Kabineti i Kryetarit përbëhet nga: Drejtor Kabineti, Këshilltar dhe Sekretar. Kabineti është i fokusuar në koordinimin dhe organizimin e punës në përshtatje me axhendën e Kryetarit, duke siguruar një marrëdhënie të qëndrueshme dhe bashkëpunuese midis Kryetarit, Komisionerëve dhe Sekretariatit.

3. Sekretari i Përgjithshëm

3.1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Ai përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarisë ditore të Sekretariatit. Ai zbaton procedura ligjore për shqyrtimin e rasteve, hartimin dhe paraqitjen e raportit përmbledhës të hetimit pranë Komisionit të Konkurrencës. Sekretari bashkërendon punën e drejtorive në Sekretariat dhe përgatit raportin vjetor të punës së Autoritetit.

3.2. Sekretari i Përgjithshëm përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Sekretariatit. Në mungesë të tij ose në pamundësi për të vepruar, me miratim të Komisionit, ai mund t'ia delegojë përgjegjësitë njërit prej drejtorëve të drejtorive të Sekretariatit. Sekretari i Përgjithshëm përgjigjet për:

- zbatimin e procedurave të ligjit për shqyrtimin e rasteve;
- hartimin dhe paraqitjen e raportit përmbledhës të hetimit para Komisionit për vendimmarrje;
- bashkërendimin e punës së drejtorive të Sekretariatit;
- përgatitjen e raportit vjetor të punës së Autoritetit;
- bashkëpunimin me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit, për zgjidhjen e çështjeve;
- nënshkrimin e korrespondencës shkresore të Sekretariatit.

4. Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregjeve Prodhuese

- 4.1. Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregjeve Prodhuese, ku bëjnë pjesë, por jo vetëm, këto tregje prodhuese: energjia, gazi dhe karburantet, ndërtimi, pyjet, industria nxjerrëse dhe minerale, agrikultura/bujqësia, peshkimi, produktet kimike, fasoneria, si dhe çdo veprimtari tjetër prodhuese.
- 4.2. Kjo drejtori ka për detyrë të bëjë vlerësimin e pozitës dominuese, sipas nenit 8 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe pas këtij procesi të hetojë nëse një nga ndërmarrjet që operojnë në këto tregje prodhuese abuzon me pozitën dominuese në treg, duke sjellë si pasojë shtrembërimin apo kufizimin e konkurrencës.
- 4.3. Gjatë realizimit të këtij procesi, kujdes do t’i kushtohet edhe vlerësimi të marrëveshjeve vertikale të këtyre ndërmarrjeve me operatorët në rrjedhën e poshtme të tregut, për të hetuar nëse ka abuzim me pozitën dominuese në format e kushtëzimit të shitjeve, blerjeve ose rishitjen e produkteve të ofruara.
- 4.4. Kjo drejtori ka për detyrë edhe vlerësimin e marrëveshjeve sipas nenit 4 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nga marrëveshjet kartel, të cilat kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, kontrollojnë tregjet ose burimet e furnizimit, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nëpërmjet manipulimit të çmimeve të shitjes apo kushteve të tjera të tregtimit.
- 4.5. Instrumenti i parashikuar nga ligji për evidentimin e këtyre shkeljeve është procesi hetimor dhe inspektues, që do të realizohet me autorizim të Komisionit të Konkurrencës rast pas rasti.
- 4.6. Drejtoria vlerëson edhe marrëveshjet e njoftuara për përjashtim nga ndërmarrjet që operojnë në këto tregje prodhuese, sipas nenit 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- 4.7. Drejtoria kryen të gjitha vlerësimet e mësipërme vetëm për tregjet prodhuese të mësipërme, por pa u kufizuar në rast të daljes dhe evidentimit të tregjeve të reja prodhuese.

5. Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregjeve të Shërbimit/Joprodhuese

- 5.1. Drejtoria synon të mbikëqyrë tregjet e shërbimit/joprodhuese, ku bëjnë pjesë, por nuk kufizohen ato tregje që ofrojnë shërbime dhe veprimtari të tjera jo prodhuese: tregu i komunikimeve elektronike, teknologjisë së informacionit dhe medias, tregu financiar, shëndetësia, turizmi, transporti, si dhe shërbimet e çdo natyre tjetër.
- 5.2. Drejtoria ka për detyrë të bëjë vlerësimin e pozitës dominuese sipas nenit 8 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe pas këtij procesi të hetojë nëse një nga ndërmarrjet që operojnë në këto tregje që ofrojnë

shërbime, abuzon me pozitën dominuese në treg, duke sjellë si pasojë shtrembërimin apo kufizimin e konkurrencës. Gjatë realizimit të këtij procesi, i rëndësishëm është dhe vlerësimi i marrëveshjeve vertikale të këtyre ndërmarrjeve me ndërmarrjet që operojnë në rrjedhën e poshtme të tregut, duke sjellë si pasojë abuzimin me pozitën dominuese në format e kushtëzimit të shitjeve, blerjeve ose rishitjen e produkteve të ofruara.

- 5.3. Kjo drejtori ka për detyrë vlerësimin e marrëveshjeve sipas nenit 4 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nga marrëveshjet kartel, të cilat caktojnë në mënyrë të drejtpërdrejta apo të tërthortë çmimet e shitjes apo çdo kusht tjetër tregtimi, kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit, duke zbatuar kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence. Instrumenti i parashikuar nga ligji për evidentimin e këtyre shkeljeve është procesi hetimor dhe inspektues që do të realizohet me autorizim të Komisionit të Konkurrencës rast pas rasti.
- 5.4. Kjo drejtori do të vlerësojë dhe marrëveshjet e njoftuara për përjashtim nga ndërmarrjet që operojnë në këto tregje shërbimi sipas nenit 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- 5.5. Kjo drejtori do të kryejë të gjitha vlerësimet e mësipërme në zbatim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës vetëm për tregjet që ofrojnë shërbime.

6. Drejtoria e Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve

- 6.1. Drejtoria e Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve angazhohet për vlerësimin e kushteve të tregjeve nëpërmjet analizave komplekse ekonomike në rastet e përqendrimeve; në rastet e dhënies së të drejtave ekskluzive, në rastet e abuzimeve me pozitën dominuese, si dhe vlerësimin e marrëveshjeve horizontale dhe vertikale ndërmjet ndërmarrjeve, në mbështetje të ligjit nr.9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- 6.2. Drejtoria do të realizojë monitorimin dhe analizën e kushteve të tregut, duke ndërtuar një bazë të dhënash për tregun në përgjithësi, por edhe për çdo përqendrim të vlerësuar në veçanti. Kjo drejtori do të kryejë analizat për autorizimin e përqendrimeve me kushte dhe detyrime sipas nenit 56, pika 1 e ligjit.
- 6.3. Struktura e propozuar parashikon që kjo drejtori do të ketë në përbërje të saj 7 (shtatë) nëpunës; 1 (një) drejtor, 5 (pesë) inspektorë dhe 1 (një) kryekonomist, edhe ky në kategorinë inspektor i mbikëqyrjes, sipas përcaktimit të dhënë në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civil të [...] disa institucioneve të pavarura [...]”, i përditësuar, lidhja nr.3 .

6.4. Kryekonomisti përbën një pozicion kyç në këtë drejtori, dhe do të realizojë në mënyrë të veçantë analiza të thelluara ekonomike dhe ekonometrike mbi të dhënat për tregjet. Adoptimi i qasjeve bashkëkohore metodologjike dhe empirike në analizat sasiore dhe cilësore, përmbushin një nga rekomandimet e rëndësishme të lëna nga partneret tanë evropianë dhe organizmat ndërkombëtarë, të cilët mbështesin Autoritetin e Konkurrencës, veçanërisht Konferenca e Kombeve të Bashkuar për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD).

7. Drejtoria Juridike, Integritit dhe Çështjeve Gjyqësore

7.1. Drejtoria Juridike, si një drejtori kryesore në realizimin e funksionit të Autoritetit të Konkurrencës, për të siguruar një analizë të mirëfilltë juridike të çdo rasti, për të bërë një opionencë konstruktive të çdo projekt-akti normativ që ndikon konkurrencën, si dhe për të siguruar një mbrojtje profesionalisht të bazuar në prova dhe ligj përballë gjykatave.

7.2. Drejtoria Juridike, Integritit dhe Çështjeve Gjyqësore do të ketë për detyrë edhe në vazhdimësi vlerësimin e shkallës së kufizimit ose pengimit të konkurrencës së akteve normative (neni 69, 70), hartimin e projekt-vendimeve të Komisionit, hartimin e akteve nënligjorë për mirëfunksionimin e veprimtarisë së Autoritetit, si dhe administrimin dhe ndjekjen me rigorozitet të proceseve gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

7.3. Gjithashtu, kjo drejtori, rast pas rasti, do të angazhohet edhe në procesin e hetimit në mbështetje të drejtorive që mbulojnë funksionet kryesore të mbikëqyrjes së tregjeve respektive, sipas ligjit.

7.4. Ka një rol kyç për vetë rëndësinë, që ka procesi i integritit dhe ku Autoriteti udhëheq Kapitullin e 8-të të këtij procesi dhe është pjesë e drejtpërdrejtë e negociatave për anëtarësim.

8. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit

8.1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit do të kryejë mirëmenaxhimin e fondeve financiare, burimeve njerëzore, si dhe administrimin e brendshëm (shërbimet) të veprimtarisë së institucionit.

8.2. Drejtoria do të kryejë edhe funksionet e menaxhimit të burimeve njerëzore/analist i punës, të përbërë nga 1 (një) drejtor, 2 (dy) përgjegjës sektori, 5 (pesë) specialistë dhe dy punonjës mbështetës, shofer dhe punonjës pastrimi.

8.3. Një detyrë tjetër e rëndësishme, kjo drejtori do të realizojë edhe komunikimin në funksion të transparencës dhe advokacisë së ligjit të konkurrencës.